

PJESA E DYTË E MATERIALIT

CIKLET E BIZNESIT

I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA

1. Me cikël biznesi kuptojmë:
 - a) Ngushtimi i aktivitetit ekonomik në periudhë afatgjatë;
 - b) Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në periudhë afatgjatë;
 - c) Ngushtimi ose zgjerimi i ekonomisë rreth shtegut potencial;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

2. Recesioni prezanton rënien ekonomike në:
 - a) Një tremujor;
 - b) Dy tremujore;
 - c) a, b
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

3. Mbi 2 recesione të vazhduara, në ekonomi njihen me emrin:
 - a) Progres;
 - b) Stagnim i ekonomisë;
 - c) Depresion
 - d) a dhe b

4. Sipas Okunit rritja ekonomike prej 2%, rezulton me uljen e papunësisë prej:
 - a) 2%
 - b) 3%
 - c) 4%
 - d) 1%

5. Pika më e lartë e papunësisë në një cikël biznesi është tregues:
 - a) Real;

- b) I hershëm;
- c) I vonuar;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

6. Teoria e cikleve reale të biznesit shfaqjen e sheh në:

- a) Anën e kërkesës;
- b) Anën e ofertës;
- c) Politikën fiskale;
- d) Politikën monetare.

II. PLOTËSO VENDET E ZBRAZËTA

1. ----- Në periudhën 1854-1914 ekonomia amerikane shënoi rritje të shpejta ekonomike.
2. ----- Rënia drastike e prodhimit industrial në ekonominë amerikane në vitin 1945 rezultoi nga turrja e kërkesave për armatim.
3. ----- Pas recesionit të viteve 1981/82, deri në vitin 2001 ekonomia amerikane shënon rënie të vazhduar.
4. ----- Shkak i depresionit të ekonomisë angleze në vitet 1812-1821, ka qenë përshtatja e ekonomisë pas Luftërave të Napoleonit.
5. ----- Indikatorët të cilët lëvizin në drejtim të njëjtë me ciklet e biznesit quhen anticiklik, dhe indikatorët të cilët lëvizin në drejtim të kundërt me ciklet e biznesit quhen prociklik.
6. ----- PBB, konsumi, investimet dhe punësimi janë prociklik, normat e interesit dhe papunësia janë anticiklik.
7. ----- Pasi partia politike fiton zgjedhjet, në vitet e para zbaton politikat ekspansive monetare dhe fiskale duke lëvizur ekonominë drejt pikës më të lartë të ciklit të biznesit dhe në vitet e fundit zbaton politika restriktive monetare dhe fiskale duke lëvizur ekonominë drejt pikës më të ulët të ciklit të biznesit.

III. ZGJIDHI DETYRAT

1. Norma e papunësisë në ekonominë e Maqedonisë është 27%. Sa vite do të nevojiteshin për të ul normën e papunësisë në 21%, nëse ekonomia rritet me normë prej 6.25%? (Ligji i Okun-it).

Zgjidhje:

Ligji i Okun-it shprehet perms ekuacionit:

$\Delta U = 0.5 (Y - 2.25)$, prandaj do të kemi

$$27\% - 21\% = 0.5 (Y - 2.25)$$

$$6 = 0.5Y - 1.125$$

$$6 + 1.125 = 0.5Y$$

$$7.125 = 0.5Y$$

$$Y = 7.125 / 0.5$$

$$Y = 14.25$$

Për të ulur normën e papunësisë nga 27% në 21%, sipas ligjit të Okun-it, ekonomia duhet të rritet me 14.25%.

Dhe, sipas detyrës, në të cilën na jepet që ekonomia rritet me normë prej 6.25% në vit, rritjen prej 14.25% nëse e pjestojmë me këtë normë vjetore, do të shohim që ekonomia do të mund të ulë normën e papunësisë nga 27% në 21% për 2.28 vite.

$$(14.25\% : 6.25\% = 2.28 \text{ vite})$$

2. Norma e papunësisë në ekonominë e Maqedonisë është 28%. Sa vite do të nevojiteshin për të ul normën e papunësisë në 19%, nëse ekonomia rritet me normë prej 5.25%? (Ligji i Okun-it).

3. Supozojmë se është realizuar një investim prej 10 milion \$, prirja marxhinale për konsum është 50%, prirja marxhinale për kursim është po ashtu 50%. Investimi prej 10 milion \$ do të vijë në dorën e atyre të cilët prodhojnë të mira investuese. Sa të ardhura do të rigjeneron shuma fillestare e investimeve (10 milion \$) nën veprimin e multiplikatorit? Multiplikatori = $1/0.5$

Zgjidhje:

Meqenëse prirja marxhinale për konsum është 50% dhe prirja marxhinale për kursim është 50%, nga paratë e fituara, shfrytëzuesit e pare 50% (5 milion \$) i shpenzojnë për të mira konsumi dhe 50% (5 milion\$) i kursejnë.

Dollarët të cilët përdoren për konsum (5 milion \$) do të rrisin kërkesën për të mira dhe shërbime, dhe bizneset e këtyre veprimtarive do të zgjerojnë aktivitetet e tyre. Në momentin kur këto 5 milion \$ do të vijnë në duart e shfrytëzuesve të rinj, ato poashtu 50% (2,5 milion \$) do të konsumohen dhe 50% (2.5 milion \$) do të kursehen. Sipas logjikës së njejtë, procesi do të zhvillohet si reaksion zinxhir. Efekti i multiplikatorit të investimit të pare do të jetë si më poshtë:

$$10\ 000\ 000 + 5\ 000\ 000 + 2\ 500\ 000 + 1\ 250\ 000 + 625\ 000 + 312\ 500 + 156\ 250 + \dots \\ = 20\ 000\ 000 \$$$

Ose investimi do të rritet për : **Investimi fillestare x Multiplikatorin**

$$\text{Multiplikatori} = 1/1 - \text{MPC} \rightarrow (1/1 - 0.5) = 1/0.5$$

$$\text{Multiplikatori} = 1/0.5 = 2$$

Pra, në këtë rast investimi nën efektin e multiplikatorit do të rritet me:

$$\text{Investimi fillestare x Multiplikatorin} = 10\ 000\ 000 \$ \times 2 = 20\ 000\ 000 \$.$$

4. Supozojmë se është realizuar një investim prej 30 milion \$, prirja marxhinale për konsum është 60%, prirja marxhinale për kursim është po ashtu 40%. Investimi prej 10 milion \$

do të vijë në dorën e atyre të cilët prodhojnë të mira investuese. Sa të ardhura do të rigjeneron shuma fillestare e investimeve (10 milion \$) nën veprimin e multiplikatorit?

Multiplikatori = $1/0.4$

IV. PYETJE PËR PËRSËRITJE

1. Ç'kuptoni me ciklin e biznesit, recesionin dhe depresionin? Përse u kushtohet aq shumë vëmendje atyre?
2. Cilët indikator makroekonomik shoqërojnë depresionin dhe progresin? Rikujtoni ciklet e biznesit në ekonominë amerikane dhe angleze.
3. Pse ekonomia amerikane gjatë luftërave arrin pikat më të larta të cikleve të biznesit . Pse recesionet dhe depresionet e ekonomisë angleze pas vitit 1957 kanë përcjell tkurrjet e ekonomisë amerikane?
4. Bëjë një krahasim midis depresionit të madh ekonomik (1929/33) dhe cikleve të biznesit të viteve të fundit. Klasifikoi dallimet kryesore.
5. Si ndikon akcelatori me multiplikatorin në ciklet e biznesit? Referoju një shembull të supozuar.
6. Çfarë thot Ligji i Okun-it?
7. Shpjego teorinë e cikleve të biznesit.

KONSUMI, KURSIMET DHE INVESTIMET

I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA

1. Me kursim mjetet financiare:
 - a) Futen në qarkun e të ardhurave;
 - b) Dalin nga qarku i të ardhurave;
 - c) a, b;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

2. Me konsum mjetet financiare:
 - a) Dalin nga qarku i të ardhurave;
 - b) Futen në qarkun e të ardhurave;
 - c) a, b;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

3. Të mirat dhe shërbimet e importuara, mjetet financiare:
 - a) I fusin në qarkun e të ardhurave;
 - b) I nxjerrin nga qarku i të ardhurave;
 - c) Ndikimi është neutral;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

4. Funkzioni i konsumit tregon raportin midis të ardhurave dhe:
 - a) Kursimit;
 - b) Eksportit;
 - c) Konsumit;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

5. Funkzioni i kursimit tregon raportin midis të ardhurave dhe:

- a) Konsumit;
 - b) Eksportit;
 - c) Kursimit;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
6. Në ekonominë e sektorit privat, të ardhurat (oferta aggregate) janë të barabarta me:
- a) Konsumin;
 - b) Investimet;
 - c) a dhe b;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.
7. Në ekonominë e mbyllur, të ardhurat (oferta aggregate) janë të barabarta me:
- a) Konsumin;
 - b) Investimet dhe shpenzimet qeveritare;
 - c) a dhe b;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

II. PLOTËSO VENDET E ZBRAZËTA (G – gabim, S – saktë)

1. ----- Në vitin 2014 shpenzime më të ulëta ka shënuar ekonomia e Indisë, Maqedonisë, Kinës dhe Ruisë, të cilat për të realizuar 1% rritje kanë investuar 5.6%, 6.4%, respektivisht 6.5%.
2. ----- Ekonomitë e zhvilluara karakterizohen me pjesëmarrje të lart të konsumit dhe pjesëmarrje të ulët të kursimeve.
3. ----- SHBA është ekonomia më e fuqishme e botës, kursimet e të cilave në vitin 2013 marrin pjesë me 25.6% të PBB-së.
4. ----- Rritje më të lartë të PBB në vitin 2014 ka realizuar Kina (7.4%) dhe rritje më të vogël ka shënuar Rusia (0.5%).
5. ----- Huaja në ekonomi njihet si kursim pozitiv.

6. ----- Nga identitetet ekonomike u vërtetua se investimet nuk janë të barabarta me kursimet.

III. ZGJIDHI DEYRAT

1. Supozoni se një person planifikon të jetojë 95 vite, punësohet në moshën 30 vjeçare dhe punon deri në moshën 65 vjeçare. Periudha e punës është 35 vjet (65 – 30). Periudha në të cilën ai punësohet dhe jeton është 65 vjet (95 – 30). Të ardhurat vjetore kanë qenë 6000 \$. Në moshën 45 vjeçare ai fiton në lojërat e fatit një pasuri me vlerë 50 000 \$. Nga të dhënat e prezantuara njehso:
- Sa ka qenë konsumi mesatar vjetor pa fitimin e lotarisë?
 - Sa ka qenë konsumi mesatar vjetor pas fitimit të lotarisë?
 - Sa ka qenë kursimi vjetor i tij?

Zgjidhje:

- a) Të ardhurat e përgjithshme nga puna:

$$\text{Të ardhurat e përgjithshme} = 6000\$ \times 35 \text{ vite} = 210\,000\$$$

$$\text{Konsumi vjetor } C = 210\,000\$ / 65 \text{ vite} = 3230.77\$$$

Gjithashtu, duke pjesëtuar periudhën e punës 35 vite me periudhën nga e cila ai punësohet dhe jeton 65 vite, fitojmë një koeficient të cilin nëse e shumëzojmë me të ardhurat vjetore, fitojmë konsumin mesatar vjetor:

$$35 / 65 \times 6000\$ = 0.538 \times 6000\$ = 3230.77\$$$

- b) Koeficienti i prirjes për konsum nga pasuria:

$$\text{MPCW} = 1 / (65 - 15) = 1 / 50 = 0.02 \quad \rightarrow \text{Ku vlera 15 fitohet duke zbritur nga}$$

periudha prej kur e ka fituar lotarinë me periudhën kur është punësuar, pra $45 - 30 = 15$

$$50\,000\$ / (95 - 45) = 50\,000\$ / 50 = 1000\$$$

$$C = (0.02 \times 50\,000\$) + (0.538 \times 6000\$) = 1000\$ + 3230.77\$ = 4230.77\$$$

- c) Kursimi mesatar vjetor: $6000\$ - 3230.77\$ = 2769.2\$$

Do të thotë që kursimi vjetor arrihet kur nga të ardhurat e përgjithshme minusojmë konsumin.

2. Supozoni se një person planifikon të jetojë 96 vite, punësohet në moshën 27 vjeçare dhe punon deri në moshën 65 vjeçare. Periudha e punës është 38 vjet (65 – 27). Periudha në të cilën ai punësohet dhe jeton është 69 vjet (96 – 27). Të ardhurat vjetore kanë qenë 8000 \$. Në moshën 43 vjeçare ai fiton në lojërat e fatit një pasuri me vlerë 60 000 \$. Nga të dhënat e prezantuara njehso:
- d) Sa ka qenë konsumi mesatar vjetor pa fitimin e lotarisë?
- e) Sa ka qenë konsumi mesatar vjetor pas fitimit të lotarisë?
- f) Sa ka qenë kursimi vjetor i tij?
3. Supozojmë një model të ekonomisë së mbyllur, në të cilën kërkesa varet vetëm nga konsumi, investimet dhe shpenzimet qeveritare, ashtu si në tabelën e mëposhtme:

(1) Y – Të ardhurat kombëtare(AS)	(2) T	(3)=(1-2) YD	(3) C	(4) I	(5) G	(6) AD	Ekspansion Ekuilibër Tkurrje
6000	100	5900	6100	200	100	6400	Ekspansion
6500	100	6400	6500	200	100	6800	Ekspansion
7000	100	6900	6900	200	100	7200	Ekspansion
7500	100	7400	7300	200	100	7600	Ekspansion
8000	100	7900	7800	200	0	8000	Ekuilibër
8500	100	8400	8100	200	100	8400	Tkurrje
9000	100	8900	8400	200	200	8800	Tkurrje
9500	100	9400	8700	200	300	9200	Tkurrje
10 000	100	9900	9000	200	400	9600	Tkurrje

Nga të dhënat e tabelës njehso:

- a) Kërkesën aggregate (plotëso kolonën e VII)
- b) Përcakto pozitat kur ekonomia ndodhet në ekspansion, ekuilibër dhe recession (Kolona e VIII)

Zgjidhje:

- a) Kërkesa aggregate $AD = C + I + G$ (Mbledhim vlerat e kolonës IV, V dhe VI)
- b) Ekonomia ndodhet në ekspansion kur $AD > Y$ (Kur vlerat e kolonës së VII janë më të mëdha se vlerat e kolonës së I); Ekonomia ndodhet në ekuilibër kur $AD = Y$;
Ekonomia ndodhet në recession kur $AD < Y$.
4. Supozojmë një model të ekonomisë së mbyllur, në të cilën kërkesa varet vetëm nga konsumi, investimet dhe shpenzimet qeveritare, ashtu si në tabelën e mëposhtme:

(3) Y – Të ardhurat kombëtare(AS)	(4) T	(3)=(1-2) YD	(3) C	(4) I	(5) G	(6) AD	Ekspansion Ekuilibër Tkurrje
4000	50	3950	4000	150	50		
4500	50	4450	4200	150	50		
5000	50	4950	4600	150	50		
5500	50	5450	5100	150	50		
6000	50	5950	5800	150	0		
6500	50	6450	6000	150	50		
7000	50	6950	6200	150	70		
7500	50	7450	6600	150	90		
8000	50	7950	7000	150	110		

Nga të dhënat e tabelës njehso:

- c) Kërkesën aggregate (plotëso kolonën e VII)
- d) Përcakto pozitat kur ekonomia ndodhet në ekspansion, ekuilibër dhe recession (Kolona e VIII)

5. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë shuma të supozuara të kursimeve dhe investimeve:

Modeli i një ekonomie të hapur (në 000 000\$)

Kursimi (S)	Investimet (I)	Deficiti buxhetor (DB)	Ekspoti neto (Nx)
1000	1000	0	0
1000	800	200	0
1000	700	0	300
1000	1300	-100	-200

Njehso deficitin buxhetor dhe eksportin neto duke u bazuar në formula $S - I = (G + TR - TA) + Nx$, nëse:

- Kursimet janë të barabarta me investimet;
- Deficiti buxhetor mbulohet nga kursimet;
- Kursimet private u kanë dhënë hua prej 300 milion \$ të huajve.
- Qeveria ka marr hua nga vendi prej 100 milion \$ dhe nga jashtë hua prej 200 milion \$.

Zgjidhje:

a) $S - I = (G + TR - TA) + Nx$

$$1000 - 1000 = 0 + 0$$

b) $S - I = (G + TR - TA) + Nx$

$$1000 - 800 = 200 + 0$$

c) $S - I = (G + TR - TA) + Nx$

$$1000 - 700 = 0 + 300$$

d) $S - I = (G + TR - TA) + Nx$

e) $1000 - 1300 = -100 - 200$

Modeli i një ekonomie të hapur (në 000 000\$)

Kursimi (S)	Investimet (I)	Deficiti buxhetor (DB)	Ekspoti neto (Nx)
1200	1200		
1500	600		
2000	1400		
2500	2000		

Njehso deficitin buxhetor dhe eksportin neto duke u bazuar në formula $S - I = (G + TR - TA) + Nx$, nëse:

- Kursimet janë të barabarta me investimet;
- buxhetor mbulohet nga kursimet;
- Kursimet private u kanë dhënë hua prej 600 milion \$ të huajve.
- Qeveria ka marr hua nga vendi prej 200 milion \$ dhe nga jashtë hua prej 300 milion \$.

IV. PYETJE PËR PËRSËRITJE

- Pse konsumi, kursimet dhe investimet janë aq të rëndësishme për ekonominë? Si ndikojnë ato në futjen dhe daljen e të ardhurave në qarkun e një ekonomie kombëtare?
- Çfarë tregon struktura e konsumit në një ekonomi kombëtare? Ç'kuptoni me prirjen marxhinale për konsum (MPC) dhe prirjen marxhinale për kursim (MPS)?
- Pse është e rëndësishme të analizohet teoria e ciklit jetësor të konsumit dhe teoria e të ardhurave permanente? Ilustro me një shembull hipotetik dhe komento të dhënat.
- Pse shkenca ekonomike i kushton rëndësi efikasitetit të investimeve?
- A paraqet problem kursimi i ulët në ekonominë amerikane?
- Përsëriti dhe analizo identitetet makroekonomike.

TREGU I PUNËS DHE PAPUNËSIA**I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA**

1. Sipas ligjit të të ardhurave marxhinale fitimi shtesë nga kostot shtesë rritet në përpjestim:
 - a) Të njëjtë;
 - b) Të rritur;
 - c) Të zvogëluar;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

2. Firmat e biznesit angazhojnë punëtorë shtesë deri në nivelin kur kostot marxhinale:
 - a) Janë më të larta nga të ardhurat marxhinale;
 - b) Barazohen me të ardhurat marxhinale;
 - c) a,b;
 - d) Asnjëra nga të mësipërmet.

3. Kurba e prodhimit marxhinal ka pozitë:
 - a) Vertikale;
 - b) Horizontale;
 - c) Pjerrtësi rënëse;
 - d) Pjerrtësi rritëse.

4. Kurba e ofertës për fuqi punëtore ka pozitë:
 - a) Horizontale;
 - b) Pjerrtësi rritëse;
 - c) Pjerrtësi rënëse;
 - d) Asnjërën nga të mësipërmet.

5. Papunësia ciklike është pasojë e:
 - a) Kërkesës për vende të reja më të mira të punës;

- b) Mos përputhjes së ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore;
 - c) Lëvizjeve ciklike të ekonomisë;
 - d) a dhe b.
6. Papunësia strukturore është pasojë e:
- a) Lëvizjeve ciklike të ekonomisë;
 - b) Ndryshimeve të stinëve të vitit (sezonit);
 - c) Mos përputhje e ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore.

II. PLOTËSO VENDET E ZBRAZËTA (G – gabim, S – saktë)

1. ----- Rritja e mëditjeve reale rezulton me tkurrjen e ofertës për fuqi punëtore për 2 arsye: e para, punëtorët e punësuar do të rrisin ofertën për orë shtesë dhe e dyta, personat e papunë do të pranohin të punësohen.
2. ----- Sipas Maltusit në kapitalin fiks (token), shtimi i ofertës për punë në periudhën e para revolucionit industrial rezulton me prodhim marxhinal rënës.
3. ----- Të ardhurat zbritëse nuk nënkuptojnë zvogëlim të prodhimit marxhinal që rezulton me shtimin e popullsisë në rrethanat e avancimeve teknologjike.
4. ----- Kostot ekonomike të papunësisë shprehin gjendjen psikologjike të personave të cilët kërkojnë punë.
5. ----- Kostoja sociale e papunësisë prezanton diferencën midis PBB aktual dhe PBB potencial.

III. ZGJIDHI DETYRAT

1. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme njehso: a) Prodhimin marxhinal, b) Fitimin marxhinal nën supozimin se një pale këpucë kushtojnë 40\$, dhe c) Sa punëtorë do të angazhojë firma e biznesit, nën supozimin se mëditja e punëtorit është 120\$?

Numri i punëtorëve (L)	Numri i këpucëve (Prodhimi total - TP)	Prodhimi marxhinal – MP (Këpucët shtesë)	Fitimi marxhinal (MP x P)
0	0	/	/
1	10	10	400
2	19	9	360
3	27	8	320
4	34	7	280
5	40	6	240
6	45	5	200
7	49	4	160
8	52	3	120
9	54	2	80
10	55	1	40

Zgjidhje:

Prodhimi marxhinal llogaritet: $MP = \Delta TP / \Delta L$

$$MP = (10 - 0) / (1 - 0) = 10 / 1 = 10$$

$$MP = (19 - 10) / (2 - 1) = 9 / 1 = 9$$

$$MP = (27 - 19) / (3 - 2) = 8 / 1 = 8$$

.....

Fitimi marxhinal llogaritet:

Fitimi marxhinal = MP x P

$$\text{Fitimi marxhinal} = 10 \times 40\$ = 400\$$$

$$\text{Fitimi marxhinal} = 9 \times 40\$ = 360\$$$

$$\text{Fitimi marxhinal} = 8 \times 40\$ = 320\$$$

.....

Firma do të angazhojë deri në 8 punëtorë sepse mëditja e punëtorit është 120 \$ dhe në nivelin e 8 të angazhimit të punëtorëve, mëditja është e barabartë me fitimin marxhinal.

2. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme njehso: a) Prodhimin marxhinal, b) Fitimin marxhinal nën supozimin se një pale këpucë kushtojnë 60\$, dhe c) Sa punëtorë do të angazhojë firma e biznesit, nën supozimin se mëditja e punëtorit është 220\$?

Numri i punëtorëve (L)	Numri i këpucëve (Prodhimi total - TP)	Prodhimi marxhinal – MP (Këpucët shtesë)	Fitimi marxhinal (MP x P)
0	0		
1	13		
2	22		
3	30		
4	37		
5	43		
6	48		
7	52		
8	55		
9	57		
10	55		

3. Në një ekonomi kombëtare numri i personave të cilët kërkojnë punë arrin në 800 000. Personat e punësuar janë 1 100 000. Njehso normën e papunësisë.

$$\mathbf{N. P = Numri\ i\ të\ papunëve / Forca\ punëtore \times 100}$$

$$\mathbf{Forca\ punëtore = Personat\ e\ punësuar + Personat\ që\ kërkojnë\ punë}$$

$$\mathbf{Forca\ punëtore = 1\ 100\ 000 + 800\ 000 = 1\ 900\ 000}$$

$$\mathbf{Pra\ kemi: NP = 800\ 000 / 1\ 900\ 000 \times 100 = 42.1\%}$$

4. Në një ekonomi kombëtare numri i personave të cilët kërkojnë punë arrin në 750 000. Personat e punësuar janë 1 200 000. Njehso normën e papunësisë.

IV. PYETJE PËR PËRSËRITJE

1. Përse është me rëndësi njohja e tregut të punës (oferta me kërkesën për fuqi punëtore)? Ç'kuptoni me prodhimin marxhinal?
2. Çfarë pikëpamjesh shpreh Maltusi për shtimin e popullsisë? A ka pas të drejtë Maltusi sa i përket prodhimit marxhinal rënës?
3. Shpjego kostot e papunësisë.
4. Çkuptoni me normën e papunësisë dhe normën natyrore të saj?
5. Cilat janë burimet e normave të larta të papunësisë?
6. Sqaro perms paraqitjeve grafike punën vullnetare dhe të detyruar.

PARAJA DHE BANKA QENDRORE

I. ZGJIDH PËRGJIGJET E SAKTA

1. Paraja funksionin e saj si masë e vlerës e kryen:

- a) Sa herë që blerësi blen ndonjë të mirë ose shërbim;
- b) Kur marrim të mirat ose shërbimet sot dhe i paguajmë më vonë;
- c) Në mënyrë të imagjinuar (pa prezencën e saj);
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

2. Paraja si mjet qarkullimi funksionin e kryen:

- a) Sa herë që marrim hua në bankë;
- b) Kur atë e ruajmë si pasuri për ditë më të vështira;
- c) Sa herë që blejmë ndonjë të mirë ose shërbim;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

3. Paraja funksionin e saj si mjet pagese e kryen:

- a) Sa here që blejmë ndonjë të mire ose shërbim;
- b) Sa here që atë e tërheqim nga qarkullimi dhe e ruajmë si metal të çmueshëm (ar);
- c) Sa here që paranë e marrim sot dhe e paguajmë më vonë të rritur për normën e interesit;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

4. Me paranë likuide kuptojmë:

- a) Paranë thesar;
- b) Paranë e depozituar;

- c) Paranë e imagjinuar;
- d) Paranë kesh dhe ato në llogari rrjedhëse.

5. Në ekonominë e SHBA-ve agregati monetary M1 përfshin:

- a) Paratë e gatshme dhe monedhat;
- b) Paratë e gatshme, monedhat dhe dollarin i cili qarkullon jashtë shtetit, çeqet e udhëtarëve, depozitat e paafatizuar dhe depozitat e tjera;
- c) Depozitat afatgjata;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

6. Në ekonominë e Sërbisë agregati monetar M1 përfshin:

- a) M2 dhe depozitat e kursimeve në periudha afatgjata kohore;
- b) Depozitat me afat të gjatë dhe fondet institucionale;
- c) Paratë kesh dhe të gjitha mjetet tjera likuide të cilat shpejt dhe në çdo kohë mund të realizojnë transaksionet e pagesave;
- d) Asnjëra nga të mësipërmet.

II. PLOTËSONI VENDET E ZBRAZTA (G- gabim, S – saktë)

1. ----- Rritja e rezervave të deyrueshme rezulton me rritjen e potencialit kreditor të bankave të nivelit të dytë (komerciale).
2. ----- Rritja e normave të interest shoqërohet me rritjen e kredive investuese.
3. ----- Sipas monetaristëve oferta e parasë varet nga sasia e të mirave dhe shërbimeve dhe niveli i çmimeve.
4. ----- Pasuria zvogëlon kërkesën për para.
5. ----- Në ekonominë e SHBA-ve agregati monetar M2 përfshin. M0 dhe M1. Mjetet kryesore të M2 janë depozitat e kursimeve më të vogla se 1 000 000\$.

6. ----- Me agregatin monetar M3 në ekonominë e Sërbisë kuptojmë M2 dhe depozitat e kursimeve në periudha afatgjata kohore.
7. ----- Agregati monetar M4 në ekonominë e Sërbisë përfshin M3 dhe aktivet e tjera afatgjate.

III. ZGJIDHNI DETYRAT

1. Supozojmë se në bankë janë depozituar 5 000 000\$, norma e reserves së detyrueshme është 5%. Për të rrit fitimin, banka huazon paratë e saja institucioneve të tjera financiare. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme njehso multiplikatorin monetar.

	Aktiva	Pasiva
Banka e I	Rezervat 5000 000 Kredit 4 750 000	Depozitat 5000 0000
Banka e II	Rezervat 4 750 000 Kredit 4 512 500	Depozita 4 750 000
Banka e III	Rezervat 4 512 500 Kredit 4 286 875	Depozita 4 512 500
Banka e IV	Rezervat 4 286 875 Kredit 4 072 531.25	Depozita 4 286 875
Banka e V	Rezervat 4 072 531.25 Kredit 3 868 904.688	Depozita 4 072 531.25
Banka
Oferta e përgjithshme e parasë (TD)	100 000 000	100 000 000

$$TD = ID \times 1/RR \times 100$$

Ku ID – Depozitat fillestare, dhe

IRR – Normat e rezervave të detyrueshme

$$TD = ID \times 1/RR \times 100$$

$$TD = 5000\ 000\$ \times 1/5 \times 100 = 100\ 000\ 000\$$$

2. Supozojmë se në bankë janë depozituar 5 000 000\$, norma e reserves së detyrueshme është 10%. Për të rrit fitimin, banka huazon paratë e saja institucioneve të tjera financiare. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme njehso multiplikatorin monetar.

	Aktiva	Pasiva
Banka e I	Rezervat 5000 000 Kredit	Depozitat 5000 0000
Banka e II	Rezervat Kredit	Depozita
Banka e III	Rezervat Kredit	Depozita
Banka e IV	Rezervat Kredit	Depozita
Banka e V	Rezervat Kredit	Depozita
Banka
Oferta e përgjithshme e parasë (TD)		

IV. PËRGJIGJU PYETJEVE

1. Rivendosni 5 faktorët të cilët ndikojnë në kërkesën për para:

2. Rivendosni së paku 5 funksionet e Bankës Qendrore

3. Cilat janë instrumentet monetare të Bankës Qëndrore:

V. PYETJE PËR PËRSËRITJE

1. Ç'kuptoni me paranë? Përse është aq e rëndësishme ajo për ekonominë? Shpjegoni funksionet e saj.
2. Çfarë rëndësie ka masa monetare në një ekonomi kombëtare? Çfarë masash zbaton Banka Qëndrore gjatë krizave ekonomike dhe çfarë masash ajo zbaton kur ekonomia vuan nga inflacioni?
3. Ç'kuptoni me agregat monetar? Cilat janë agregatët monetar në SHBA dhe në Sërbi?
4. Ç'kuptoni me multiplikatorin e parasë? Çfarë lidhje korelative ekziston midis depozitave dhe multiplikatorit dhe çfarë lidhje ka midis multiplikatorit dhe rezervave të detyrueshme?
5. Cilat janë funksionet e Banksës Qëndrore të Sërbisë, të SHBA-ve dhe Eurozonës?
6. Cilat instrumente monetare përdor Banka Qendrore për të arrit objektivat e veta? Shpjego si veprojnë ato.